



Në bazë të nenit 17 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën e punës dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare (Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale nr. 19/09 dhe 010/17 të datës 17.03.2017), Komisioni për shpërndarjen e mjeteve për projekte të OJQ-ve të Komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më 20.06.2018 ka sjell

**VENDIM**  
**mbi shpërndarjen e mjeteve Organizatave joqeveritare**

**I – Ndahen mjetet projekteve të organizatave joqeveritare si në vijim:**

OJQ “Shoqata e personave me invaliditet- Malësia”-Me informacione drejt një jete më të drejtë  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 300,00 euro

OJQ “Labeatet”- Tuz- Film dokumentar mbi Famullinë e Shën Antonit në Tuz  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 300,00 euro

OJQ “Na ndiqni Follow us” - Follow us Sumer fest  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 200,00 euro

SHKA “BESA”- Mis bjeshka e Koritës 2018  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 600,00 euro

OJQ “Fëmijët e Malit të Zi”- Dhënia e mbështetjes për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 1500,00 euro

OJQ “Parandalimi dhe çmësimi nga bixhozi, alkooli, droga dhe veset e tjera të rrezikshme për rini”- Hapat e vegjël drejt stilit të shëndetshëm të jetës.  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 350,00 euro

OJQ SHKA “Ramadan Sharkiq”- Tuz- Pjesëmarrja në festivalet ndërkombëtare të folklorit  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 2.550,00 euro

OJQ ”Muzeu etnografik”- Përmirësimi i kapaciteteve teknike  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 300,00 euro

OJQ “Sheher”- Rikonstruktimi i çesmës në Tuz  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 1000,00 euro

OJQ “Tuzi”- pjesëmarrja në forumet ndërkufitare  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 900,00 euro

SHKA “Koha”- Manifestim me rastin e 28 nëntorit  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 1000,00 euro

OJQ “Pelikanët”- Projekt ideor i sanimit dhe revitalizimit të Samoborit Narhelm  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 600,00 euro

SHKA "Rapsha" – Libri i SHKA Rapshës  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 300,00 euro

OJQ "Skleroza e shumëfishtë"- Përmirësimi i cilësisë së jetës së pacientëve me sklerozë të shumëfishtë në Tuz  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 900,00 euro

SHKA "Lirija" – Milesh Manifestimi kulturor diaspora me ne  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 1000,00 euro

OJQ "Rizo Kolenoviq" – Kurrë nuk është vonë  
Shuma e aprovuar e mjeteve financiare: 200,00 euro

II – Ky Vendim u dorëzohet pjesëmarrësve të konkursit dhe shpallet në ueb faqen e Kryeqytetit në afat prej 8 ditësh nga dita e sjelljes

### Arsyetim

Me dispozitat e nenit 20 të Vendimit mbi financimin e projekteve të organizatave joqeveritare, është e përcaktuar që Komisioni sjell vendim mbi shpërndarjen e mjeteve në afat prej 15 ditësh nga dita e skadimit të afatit të konkursit. Vendimi mbi shpërndarje përmban: emrin e organizatës joqeveritare projektet e së cilës financohen, emri i projektit që financohet dhe shuma e mjeteve të aprovuara për çdo projekt individualisht. Kryetari i komunës me organizatë joqeveritare të cilës janë ndarë mjetet, në afat prej 10 ditëve nga dita e sjelljes së Vendimit, lidh kontratë më të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe mbikëqyrja mbi realizimin e projektit, gjegjësisht programit. Realizimi i kontratave të lidhura përcillet nga Komisioni.

Në bazë të të ekspozuarit, është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi mund të dorëzohet ankesa Kryeadministratorit në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij.

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**Naser Krkanoviq**

